



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

KONFERENCA E KRYETARËVE

VENDIM

Nr. 6, datë 10.4.2019

PËR DISA ÇËSHTJE TË RENDIT TË DITËS TË MBLEDHJES
SË KONFERENCËS SË KRYETARËVE, DATË 11.4.2019

Në mbështetje të neneve 12, 26 dhe 27 të Rregullores së Kuvendit, me propozim të Kryetarit të Kuvendit

KONFERENCA E KRYETARËVE

VENDOSI:

I. Miratohet me mirëkuptim Programi i Punës së Kuvendit për periudhën 15 prill – 31 maj 2019 me propozimet e bëra dhe i përcillet Kuvendit për njoftim në seancën plenare të datës 11.4.2019.

II. Miratohet me mirëkuptim Kalendari 3-javor i Punimeve të Kuvendit për periudhën 15 prill – 10 maj 2019, me ndryshimet e propozuara në mbledhjen e Konferencës së Kryetarëve dhe i përcillet Kuvendit për njoftim në seancën plenare të datës 11.4.2019.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Gramoz Ruci

